



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Nr. 0302-23
26.01.2024
Shkup



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk



Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.0802-15 datë 12.01.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0802-15 datë 29.01.2024 nga dr.Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.0201-399/7 datë 29.01.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në vazhdimin e parë të seancës së 4-ët mbajtur më 29.01.2024 miratoi:

AKTVENDIM

**për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 3-të mbajtur më 15.01.2024, me Konkluzion, ark.nr.0201-234/4 datë 15.01.2024, miratoi Propozimin PA1 nr.0802-15 datë 12.01.2024, për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, dorëzuar nga propozuesi, dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të jashtëzakonshme administrative, në Raportin ark.nr.0305-119/1 datë 09.01.2024, është konstatuar se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 16.01.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.0802-15 datë 16.01.2024, me të cilën është njoftuar se nëse nuk dorëzon dokumentacionin

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

përkatës nga i cili mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren e lartpërmendur, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio. Njoftimi PA1 nr.0802-15 datë 16.01.2024, është dorëzua nëpërmjet personit zyrtar (dërguesit) të Agjencisë me Librin për vend të Agjencisë drejtuar SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi në të njëjtën ditë, më 16.01.2024.

Me datë 29.01.2024, drejtua drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, është dorëzuar Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer të jashtëzakonshme administrative ark.nr.0305-498/1 datë 29.01.2024, nga ku u konstatua se SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, sipas së cilës nga ana e drejtorit, drejtuar Këshillit të Agjencisë është dorëzuar Propozim ark.nr.0802-15 datë 29.01.2024, për miratimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.0802-15 datë 12.01.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0802-15 datë 29.01.2024 nga dr.Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Konkluzionin, ark.nr.0201-399/7 datë 29.01.2024, Këshilli i Agjencisë në vazhdimin e parë të seancës së 4-ët mbajtur më 29.01.2024, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes PA1 nr.08-78 datë 07.09.2023 të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.